



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 197, Datë 03.08.2022

**MBI  
NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 40, DATË 10.03.2022  
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “LAJTHIZA INVEST” SH.A. NË  
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “QAMI  
1”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 1.730 MW”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 53, pika 2 të ligjit nr. 144/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 03.08.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1379/3 prot., datë 26.07.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 40, datë 10.03.2022 “Mbi licencimin e shoqërisë “LAJTHIZA INVEST” sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Qami 1”, me kapacitet të instaluar 1.730 MW”,

**Konstatoi se:**

- Me vendimin nr. 40, datë 10.03.2022, të ndryshuar dhe me vendimin nr. 102, datë 09.05.2022, bordi i ERE-s vendosi të licencojë shoqërinë “LAJTHIZA INVEST” sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me kusht që: 2. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga marrja dijeni e këtij vendimi, shoqëria duhet të depozitojë në ERE kontratat e rinovuara të qirasë për gjithë territorin ku shtrihet projekti, përkatësisht me Bashkinë Fushë-Arrëz dhe Bashkinë Kukës, ose çdo dokument tjetër që vërteton të drejtën e subjektit për të përdorur pronën në zonën e projektit që shtrihet te këto dy bashki. ERE i njoftoi shoqërisë vendimin nr. 102/2022 me shkresën nr. 11/11 prot., datë 23.05.2022.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 11/12 prot., datë 22.07.2022, shoqëria ka bërë me dije ERE-n se ka aplikuar pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) përkatëse për regjistrimin e kontratës që i jep të drejtën për të përdorur pronën në pjesën e territorit që projekti prek Bashkinë Kukës, më datë 15.04.2022.
- Si dhe në datën 07.07.2022, janë vënë në dispozicion të ZVRPP Kukës të gjitha dokumentet sipas kërkesës së saj.

- Në këto rrethana shoqëria është në pritje të përgjigjes nga ZVRPP përkatëse.
- Për gjithë sa më sipër deklaruar e depozituar nga shoqëria, konstatohet se ka bërë aplikimet përkatëse brenda afatit 30-ditor të përcaktuar në vendim (afati i fundit data 07.07.2022).
- Për sa më sipër dhe duke qenë se shoqëria ka dokumentuar në ERE përpjekjet e saj dhe aplikimet përkatëse për t'u pajisur me dokumentacionin pronësor, vlerësohet që t'i lihet afat depozitimi i këtij dokumentacioni në ERE brenda 60 ditëve pune, afati i cili fillon nga data 07.07.2022.
- Në nenin 53, pika 2 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: *“Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, nëse ligji ose aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për kryerjen e një veprimi procedural, organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit”.*

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Pika 2 e vendimit nr. 40, datë 10.03.2022, të bordit të ERE-s ndryshon dhe bëhet:
  2. *Shoqëria duhet të depozitojë në ERE kontratat e rinovuara të qirasë me Bashkinë Kukës, ose çdo dokument tjetër që vërteton të drejtën e subjektit për të përdorur pronën në zonën e projektit që shtrihet te kjo bashki, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve pune, duke filluar ky afat nga data 07.07.2022.*
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**